



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government / Ministarstvo Lokalne Samouprave

**RREGULLORE Nr. 01 / 2020 PËR SISTEMIN E MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS KOMUNALE DHE SKEMËS SË
GRANTIT PËR PERFORMANCË KOMUNALE**

**UREDBU Br. 01 / 2020 O SISTEMU UPRAVLJANJA UČINKOM OPŠTINA I ŠEMU GRANTOVA OPŠTINSKOG
UČINKA**

**REGULATION NO. 01 / 2020 ON MUNICIPAL PERFORMANCE MANAGEMENT SYSTEM AND MUNICIPAL
PERFORMANCE GRANT SCHEME**

Ministri i Ministrisë së Pushtetit Lokal	Ministar Ministarstva lokalne samouprave	Minister of the Ministry of Local Government
Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, (QRK) - NR. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (shtojca 13), si dhe nenin 38 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr.09/2011 (GZ Nr. 15, 12.09.2011), ministri	Na osnovu Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, (VRK) - BR. 05/2020 o oblastima administrativne odgovornosti kancelarije premijera i ministarstava (aneks 13), kao i člana 38. stav 6. Pravilnika o radu Vlade Republike Kosovo br. 09/2011 (SL br. 15, 12.09.2011), ministar	Pursuant to the Law No. 03/L-040 on Local Self Government, Regulation (GRK) - No. 05/2020 on the Areas of Administrative Responsibility of The Office of the Prime Minister and Ministries (Annex 13), as well as Article 38, paragraph 6 of the Regulation No. 09/2011 of Rules of Procedure of the Government of the Republic of Kosovo (OG No. 15, 12.09.2011), minister
Nxjerr:	Donosi:	Issues the following:
RREGULLORE Nr. 01/2020 PËR SISTEMIN E MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS SË KOMUNAVE DHE SKEMËS SË GRANTIT PËR PERFORMANCË KOMUNALE	UREDBU Br. 01/2020 O SISTEMU UPRAVLJANJA UČINKOM OPŠTINA I ŠEMA GRANTOVA OPŠTINSKOG UČINKA	REGULATION NO. 01/2020 ON MUNICIPAL PERFORMANCE MANAGEMENT SYSTEM AND MUNICIPAL PERFORMANCE GRANT SCHEME
KAPITULLI I - DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	POGLAVLJE I – OPŠTE ODREDBE	CHAPTER I – GENERAL PROVISIONS
Neni 1 Qëllimi	Član 1. Cilj	Article 1 Purpose
1.1 Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i parimeve, rregullave, procedurave dhe standardeve për sistemin e performancës së komunave dhe	1.1 Cilj ove Uredbe je utvrđivanje pravila, principa, postupaka i standarda za merenje učinka opština u pružanju usluga građanima i funkcionisanju šeme granta za učinak.	1.1 The aim of this Regulation is to establish principles, rules, procedures and standards for municipal performance system and functioning of municipal performance grant scheme.

funksionimit të skemës së grantit për performancë komunale. 1.2. Me këtë rregullore përcaktohet: 1.2.1. Ngritja dhe funksionimi i sistemit të menaxhimit të performancës komunale; 1.2.2. Hapat për planifikim, koordinim, raportim, verifikim dhe publikim të rezultateve të performancës komunale; 1.2.3. Strukturat përgjegjëse në nivel lokal dhe qendror për menaxhimin e sistemit të performancës komunale; 1.2.4. Udhëzimet referuese në dokumentet profesionale të sistemit të menaxhimit të performancës komunale; 1.2.5. Përbajtja e sistemit të cilësisë dhe për procesin e verifikimit të të dhënave të performancës komunale; 1.2.6. Zhvillimi dhe funksionimi i skemës së grantit të performancës komunale. 1.2.7. Përcatimi i procedurave për ndryshimin e SPMK-ës.	1.2. Ovom uredbom se utvrđuje: 1.2.1. Izgradnja i funkcionisanje sistema upravljanja opštinskim učinkom; 1.2.2. Koraci za planiranje, koordinaciju, izveštavanje, verifikaciju i objavljivanje rezultata opštinskog učinka; 1.2.3. Odgovorne strukture na lokalnom i centralnom nivou za upravljanje podacima opštinskog učinka; 1.2.4. Referentne smernice u stručnim dokumentima sistema upravljanja opštinskim učinkom; 1.2.5. Sadržaj sistema kvaliteta i metodologije za proces verifikacije podataka opštinskog učinka; 1.2.6. Razvoj i funkcionisanje šeme granta opštinskog učinka. 1.2.7. Određivanje procedura za promenu SUOU-a	1.2. This Regulation shall determine: 1.2.1. The establishment and functioning of the municipal performance management system; 1.2.2. Steps for planning, coordination, reporting, verification and publication of municipal performance results; 1.2.3. Responsible structures at the local and central level for managing municipal performance data; 1.2.4. Reference guidelines in professional documents of the municipal performance management system; 1.2.5. Content of the quality system and methodology for the municipal performance data verification process; 1.2.6. Development and functioning of the municipal performance grant scheme. 1.2.7. Setting procedures for the change of MPMS.
---	--	---

Neni 2 Fushëveprimi Kjo Rregullore është e aplikueshme për matjen e performancës së komunave në ushtrimin e kompetencave vetanake sipas Sistemit të Menaxhimit të Performancës Komunale, që zbatohet nga institucionet e nivelit lokal dhe ministria përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe për funksionimin e skemës së Grantit për Performancë Komunale.	Član 2. Delokrug Ova Uredba se primenjuje za merenje učinka opština u izvršavanju sopstvenih nadležnosti prema Sistemu za upravljanje opštinskim učinkom, koji se sprovodi od strane institucija lokalnog nivoa i nadležnog ministarstva za lokalnu samoupravu, kao i za funkcionisanje šeme grantova za opštinski učinak:	Article 2 Scope This Regulation shall apply to the measurement of municipality's performance in the exercise of their own competencies under the Municipal Performance Management System, which is implemented by the local level institutions and ministry responsible for local self government and for the functioning of the Municipal Performance Grant Scheme.
Neni 3 Përkufizimet Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim: 3.1. Ministria - nënkupton Ministrinë e Pushtetit Lokal. 3.2. Performancë komunale – nënkupton nivelin e arritjeve të komunave në kuadër të një apo më shumë fushave të kompetencave të tyre, si rezultat i një procesi standard të mbledhjes, analizimit, përpunimit dhe të raportimit të të dhënave. 3.3. Sistemi i menaxhimit të performancës komunale (SMPK) - nënkupton një instrument për vlerësimin e	Član 3. Definicije Izrazi korišćeni u ovoj uredbi imaju sledeće značenje: 3.1. Ministarstvo – podrazumeva Ministarstvo lokane samouprave. 3.2. Opštinski učinak – podrazumeva nivo postignuća opština u okviru jedne ili više oblasti svojih nadležnosti, kao rezultat standardnog procesa prikupljanja, analize, obrade i izveštavanja podataka. 3.3. Sistem upravljanja opštinskim učinkom (SUOU) - podrazumeva jedan instrument za procenu učinka opština na	Article 3 Definitions The terms used in this Regulation shall have the following meanings: 3.1. Ministry – shall mean the Ministry of Local Government. 3.2. Municipal performance – shall mean the level of performance of municipalities within one or more areas of their competencies, as a result of a standard process of data collection, analysis, processing and reporting. 3.3. Municipal Performance Management System (MPMS) – shall mean an tool for the assessment of

performancës së komunave bazuar në fusha, rezultate dhe tregues dhe të dhëna.	osnovu oblasti, rezultata, pokazatelja i podataka.	municipalities' performance based on areas, results, indicators, and data.
3.4. Dokumenti kryesor i SMPK-së - nënkupton dokumentin që përshkruan konceptet themelore të ndërtimit dhe funksionimit të SMPK-së, hapat dhe procesin e matjes së performancës komunale, përmbajtjen e fushave, rezultateve dhe treguesve të performancës, si dhe dokumentet tjera përcjellëse për zbatimin e SMPK-së.	3.4. Glavni dokumenat SUOU-a – podrazumeva dokumenat koji opisuje osnovne koncepte izgradnje i funkcionisanja SUOU-a, korake i proces merenja opštinskog učinka, sadržaj oblasti, rezultata i pokazatelja učinka, kao i druga prateća dokumenta za sprovođenje SUOU-a.	3.4. MPMS Main document – shall mean a document that describes the basic concepts of development and functioning of MPMS, steps and process of measuring municipal performance, the content of areas, results and indicators of performance, as well as other supporting documents for the implementation of MPMS.
3.5. Zyrtar komunal për raportim të performancës - nënkupton zyrtarin e komunës i cili caktohet nga kryetari i komunës, përgjegjës për grumbullimin, verifikimin dhe raportimin e të dhënave zyrtare të komunës, të përcaktuara me SMPK, për matjen e performancës së komunës përkatëse.	3.5. Opštinski službenik za izveštavanje o učinku – podrazumeva službenika opštine imenovanog od strane gradonačelnika, odgovornog za prikupljanje, verifikaciju i izveštavanje zvaničnih podataka opštine, utvrđenih od strane SUOU-a, za merenje učinka dotične opštine.	3.5. Municipal Performance Reporting Officer – shall mean a municipal officer appointed by the Mayor, responsible for collecting, verifying and reporting official municipal data, established by the MPMS, to measure the performance of the municipality concerned.
3.6. Koordinatori komunal për performancë - nënkupton zyrtarin publik të komunës përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të aktiviteteve rreth menaxhimit të sistemit të performancës komunale në komunë.	3.6. Opštinski koordinator za učinak – podrazumeva javnog službenika opštine odgovornog za opštu koordinaciju aktivnosti oko upravljanja sistemom opštinskog učinka u opštini.	3.6. Municipal Performance Coordinator – shall mean a municipal public officer responsible for the general coordination of activities on the management of the municipal performance system in the municipality.
3.7. Njësia përgjegjëse në ministri – nënkupton departamentin apo njësinë përgjegjëse për performancë komunale.	3.7. Odgovorna jedinica u ministarstvu – podrazumeva odeljenje ili jedinicu odgovornu za opštinski učinak.	3.7. Responsible unit in the Ministry – shall mean the department or unit responsible for municipal performance.

3.8. Granti i performancës komunale (GPK) – instrument financiar me karakter stimulues që u ndahet komunave në baza periodike, bazuar në kriteret e veçanta në raport me performancën e arritur.	3.8. Grant opštinskog učinka (GOU) – finansijski instrument stimulativnog karaktera koji se dodeljuje opštinama na periodičnoj osnovi, na osnovu posebnih kriterijuma u odnosu na postignuti učinak.	3.8. Municipal Performance Grant (MPG) – a financial instrument that is intended as an incentive to be allocated to municipalities on a periodic basis, based on special criteria in relation to the achieved performance.
3.9. Rregullat e grantit për performancës komunale – nënkupton sistemin e rregullave të veçanta të aprovuara nga ministria dhe kontributdhënësit, me të cilat përcaktohen kriteret dhe mënyra e vlerësimit të komunave për qëllim të përfitimit nga skema e grantit për performancë komunale.	3.9. Pravila granta za opštinski učinak – podrazumeva sistem posebnih pravila odobrenih od strane ministarstva i doprinosioca, kojim se utvrđuju kriterijumi i način procene opština u cilju koristi od šeme granta za opštinski učinak.	3.9. Municipal Performance Grant Rules – shall mean a system of special rules approved by the ministry and the contributors, which shall determine the criteria and manner to evaluate municipalities in order to benefit from the municipal performance grant scheme.
3.10. Sistemi elektornik i menaxhimit të performancës komunale (SEMPK) - nënkupton sistemin kompjuterik i cili mundëson lidhjen në mes të komunave dhe ministrisë për qëllim të komunikimit, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave.	3.10. Elektronski sistem upravljanja opštinskim učinkom (ESUOU) – podrazumeva računarski sistem koji omogućava vezu između opština i ministarstva radi komunikacije, obrade, i čuvanja podataka.	3.10. Electronic Municipal Performance Management System (EMPMS) – shall mean a computer system that enables the connection between municipalities and ministry in order to communicate, process, and maintain data.
3.11. Përdoruesit e SEMPK-së – nënkuptojnë personat e autorizuar të cilët kanë qasje në SEMPK sipas niveleve të autorizimit të përcaktuar me nenin 26 të kësaj rregullore.	3.11. Korisnici ESUOU - podrazumevaju ovlašćena lica koja imaju pristup ESUOU-u u skladu sa nivoima ovlašćenja utvrđenim u članu 26. ove uredbe.	3.11. EMPMS Users – shall mean authorized persons who have access to EMPMS according to the levels of authorization defined by Article 26 of this Regulation.
3.12. Kontributdhënës të grantit – nënkupton subjektet publike apo jopublike të cilët ofrojnë mbështetje financiare për komunat përmes skemës së grantit për performancë komunale.	3.12. Doprinosioc granta – podrazumeva javne ili nejavne subjekte koji pružaju finansijsku podršku za opštine putem šeme granta za opštinski učinak.	3.12. Grant Contributor – shall mean public or non-public entities that provide financial support to municipalities through the municipal performance grant scheme.

3.13. Cilësia e të dhënave – do të thotë se të dhënat e raportuara nga komunat janë të sakta, të vërteta, të mbështetura me fakte dhe dokumente zyrtare, të cilat dëshmojnë një proces, ngjarje, veprim apo punë konkrete, duke ofruar pasqyrë reale të performancës komunale. 3.14. Palë e interesit – ministritë, komunat, kontributdhënësit, shoqëria civile dhe qytetarët.	3.13. Kvalitet podataka - znači da su podaci koje izveštavaju opštine tačni, istiniti, podržani zvaničnim činjenicama i dokumentima, koji dokazuju proces, događaj, radnju ili konkretan rad, pružajući realnu sliku o učinku opštine. 3.14. Zainteresovane strane - ministarstva, opštine, doprinosioci, civilno društvo i građani.	3.13. Data quality – shall mean that the data reported by the municipalities are accurate, genuine, supported by formal facts and documents, which are an evidence for a process, event, action, or concrete work, providing a realistic overview of municipal performance. 3.14. Stakeholder – ministries, municipalities, contributors, civil society and citizens.
Neni 4 Parimet 4.1. Sistemi i menaxhimit të performancës komunale bazohet në këto parime: 4.1.1. Parimi i ligjshmërisë - organet përgjegjëse veprojnë në pajtim me rregullat e legjislacionit të zbatueshëm për matjen e performancës komunale. 4.1.2. Parimi i transparencës – nënkupton qasjen e hapur për qytetarët dhe palët e tjera të interesit në informatat lidhur me performancën komunale; 4.1.3. Parimi i subsidiaritetit – matja e performancës shtrihet për aq sa është e mundur tek ofruesit më të afërt të	Član 4. Principi 4.1. Sistem upravljanja opštinskim učinkom zasniva se na sledećim principima: 4.1.1. Princip zakonitosti - podrazumeva odgovorne organe koji deluju u skladu sa pravilima važećeg zakonodavstva za merenje opštinskog učinka. 4.1.2. Princip transparentnosti – podrazumeva otvoreni pristup za građane i druge zainteresovane strane u vezi sa opštinskim učinkom, kao i uključivanje u razvoj politika za opštinski učinak.	Article 4 Principles 4.1. The municipal performance management system is based on the following principles: 4.1.1. Principle of legality - responsible bodies act in accordance with the rules of applicable legislation for the measurement of municipal performance. 4.1.2. Principle of transparency – shall mean open access for citizens and other stakeholders to information on the municipal performance. 4.1.3. Principle of subsidiarity– the measurement of performance extends as far as possible to the nearest service

shërbimeve ndaj qytetarëve, si dhe ndikimi i grantit reflekton interesat dhe nevojat e qytetarëve të komunës. 4.1.4. Parimi i meritës – niveli i performancës së arritur ndikon në rradhitjen e komunave sipas rezultateve të treguara në ushtrimin e kompetencave në fushat e matura. Granti i performancës komunale merr parasysh nivelin e performancës së arritur të komunave. 4.1.5. Parimi i efikasitetit dhe efektivitetit - organet përgjegjëse në nivel lokal dhe qendror sigurojnë zbatimin e thjeshtë dhe ekonomik, në kohë të arsyeshme dhe mënyrë profesionale të rregullave dhe procedurave administrative për matjen e performancës komunale, si dhe funksionimin e grantit të performancës komunale. 4.1.6 Parimi i vlefshmërisë – organet përgjegjëse krijojnë mekanizmat e nevojshëm profesional, administrativ dhe ligjor për të matë atë që synohet të matet dhe jo diçka tjetër. 4.1.7. Parimi i barazisë - në kontekst të SMPK-së dhe grantit të performancës komunale, komunat nuk	4.1.3. Princip subsidijarnosti – podrazumeva da se merenje učinka prostire koliko je moguće na najbliže pružaoce usluga građanima, kao i uticaj granta odražava interese i potrebe najvećeg broja građana opštine. 4.1.4. Princip zasluge – podrazumeva da nivo postignutog učinka utiče na rangiranje opština u skladu sa rezultatima prikazanim u vršenju nadležnosti u merenim oblastima. Grant opštinskog učinka uzima u obzir nivo postignutog učinka opština. 4.1.5. Princip efikasnosti i delotvornosti - odgovorni organi na lokalnom i centralnom nivou osiguravaju jednostavno i ekonomsko sprovođenje, u razumnom roku i na profesionalan način upravnih pravila i postupaka za merenje opštinskog učinka, kao i upravljanje grantom opštinskog učinka. 4.1.6 Princip vrednosti – Podrazumeva da odgovorni organi stvaraju potrebne profesionalne, administrativne i zakonske mehanizme za merenje onog što se cilja meriti, a ne nešto drugo.	providers to citizens. Also, the impact of the grant reflects the interests and needs of citizens of municipality. 4.1.4. Principle of merit – level of performance achieved has an effect on the ranking of municipalities according to the results shown in the exercise of competencies in the measured areas. The Municipal Performance Grant takes into account the level of municipal performance achieved. 4.1.5. Principle of effectiveness and efficiency - responsible bodies at the local and central level shall ensure a simple and economic implementation of administrative rules and procedure for the measurement of municipal performance within a reasonable time and in a professional manner, as well as the functioning of the municipal performance grant. 4.1.6 Principle of validity – responsible bodies shall create necessary professional, administrative and legal mechanisms to measure what is intended to be measured, and not something else. 4.1.7. Principle of equality – in the context of the MPMS and the
--	---	--

diskriminohen në bazë të karakteristikave gjeografike dhe demografike apo strukturës etnike të popullatës.

4.1.8. **Parimi i zbatueshmërsë** – sistemi përcakton në mënyrë të qartë objektin dhe mënyrën e matjes, si dhe përgjegjësitë për matje me qëllim të përmirësimit të shërbimeve në komuna.

KAPITULLI II

SISTEMI I MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS KOMUNALE

Neni 5 Elementet përbërëse të SMPK-së

1. SPMK formohet dhe funksionon sipas elementeve përbërëse të bazuara në këtë strukturë hierarkike: fushë, rezultat, tregues dhe të dhëna;

1.1. **Fushat** - shprehin grupin e të drejtave dhe obligimeve që komunat i ushtrojnë në shërbim të qytetarëve mbi bazën e kompetencave ligjore;

4.1.7. **Principi i njëqindë** – podrazumeva da u kontekstu SUOU-a i granta opštinskog učinka, opštine nisu diskriminisane na osnovu njihovih geografskih i demografskih karakteristika ili etničke strukture stanovništva.

4.1.8. **Principi i sprovodljivosti** – podrazumeva da sistem jasno utvrđuje objekat i način merenja, kao i odgovornosti za merenje u cilju poboljšanja usluga u opštinama.

POGLAVLJE II

SISTEM UPRAVLJANJA OPŠTINSKIM UČINKOM

Član 5. Sastavni elementi SUOU-a

1. SUOU se formira i funkcioniše u skladu sa sastavnim elementima zasnovanima na hijerarhijsku strukturu: oblast, rezultat, pokazatelje i podatke;

1.1. **Oblasti** - izražavaju grupu prava i obaveza koje opštine vrše u službi građana na osnovu zakonskih nadležnosti.

municipal performance grant, municipalities are not discriminated against on the basis of their geographical and demographical characteristics or ethnic structure of the population.

4.1.8. **Principle of feasibility** – the system clearly defines the subject and method of measurement, as well as responsibilities for measurement in order to improve services in municipalities.

CHAPTER II

MUNICIPAL PERFORMANCE MANAGEMENT SYSTEM

Article 5 Constituent elements of MPMS

1. The MPMS is formed and functions according to the constituent elements based on the following hierarchical structure: area, result, indicators and data;

1.1. **Areas** – shall stipulate the group of rights and obligations that municipalities shall exercise in the

1.2. Rezultatet - tregojnë se shërbimet janë ofruar në sasinë apo cilësinë e planifikuar, mbi bazën e kapaciteteve që ka komuna apo kriterëve përkatëse të vendosura paraprakisht. Rezultati tregon se organet komunale kanë përmbushur standardet ligjore të qeverisje; 1.3. Treguesit - Përfaqësojnë bazën kryesore llogaritëse për shkallën e arritjes së rezultateve; 1.4. Të dhënat – Janë parametra që korrespondojnë me fakte apo statistika që shërbejnë për llogaritjen e treguesit. 2. Ndryshimet në përkufizime, shtim apo largim të fushës, rezultatit, treguesit apo të dhënave, i nënshtrohen procesit formal për ndryshim të SMPK-së sipas kapitullit VI të kësaj Rregulloreje.	1.2. Rezultati - pokazuju da se usluge pružaju u planiranom iznosu ili kvalitetu, na osnovu kapaciteta opštine ili relevantnih kriterijuma koji su unapred postavljeni. Rezultat takođe pokazuje da su opštinski oragni ispunili zakonske standarde upravljanja. 1.3. Pokazatelj - predstavljaju glavnu računsku osnovu za stepen postignuća rezultata. 1.4. Podaci - su parametri koji odgovaraju činjenicama ili statistikama koji služe za izračunavanje pokazatelja. 2. Izmene u definicijama, dodavanje ili uklanjanje oblasti, rezultata, pokazatelja ili podataka, podleže formalnom postupku za izmenu SUOU-a u skladu sa poglavljem VI ove Uredbe.	service to citizens on the basis of legal competencies. 1.2. Results – shall indicate that the services are provided in the quantity or quality as planned, based on the available capacity of municipality or the relevant criteria set in advance. The result also indicates that municipal bodies have met legal governance standards. 1.3. Indicators – shall represent the main basis of calculation for the degree of result achievement. 1.4. Data - are parameters that correspond to the facts or statistics that serve to calculate the indicator. 2. Changes in definitions, addition or removal of areas, results, indicators or data, is subject to the formal process for amending the MPMS in accordance with Chapter VI of this Regulation.
---	--	---

KAPITULLI III PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE TË SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË PERFORMANCËS KOMUNALE Neni 6 Përgjegjësitë e ministrisë 1. Ministria është institucion përgjegjës për menaxhimin e SMPK-së dhe Grantit për Performancë Komunale. 2. Në funksion të zbatimit të kësaj rregullore, ministria siguron: 2.1. Ndërtimin e kapaciteteve të mjaftueshme për menaxhimin e SMPK-së dhe grantit për performancë komunale, përmes njësisë së veçantë organizative përgjegjëse për performancë; 2.2. Hartimin, zhvillimin dhe zbatimin e politikave për matjen e performancës komunale; 2.3. Hartimin dhe përditësimin e dokumentit kryesor të SMPK-së dhe instrumenteve përcjellëse profesionale në konsultim me komunat dhe palët e tjera të interesit;	POGLAVLJE III INSTITUCIONALNE ODGOVORNOSTI SISTEMA UPRAVLJANJA OPŠTINSKIM UČINKOM Član 6. Odgovornosti ministarstva 1. Ministarstvo je institucija odgovorna za upravljanje SUOU-om i grantom za opštinski učinak. 2. U funkciji sprovođenja ove uredbe, ministarstvo osigurava: 2.1. Izgradnju dovoljnih kapaciteta za upravljanje SUOU-om i grantom za opštinski učinak, kroz posebnu organizacionu jedinicu odgovornu za učinak; 2.2. Izradu, razvoj i sprovođenje politika za merenje opštinskog učinka; 2.3. Izradu i ažuriranje glavnog dokumenta SUOU-a i pratećih profesionalnih instrumenata u konsultaciji sa opštinama i drugim zainteresovanim stranama;	CHAPTER III INSTITUTIONAL RESPONSIBILITIES REGARDING MUNICIPAL PERFORMANCE MANAGEMENT SYSTEM Article 6 Responsibilities of the Ministry 1. The Ministry is the institution responsible for the management of the MPMS and the Municipal Performance Grant. 2. In order to implement this Regulation, the Ministry shall ensure: 2.1. adequate capacity building to manage the MPMS and the municipal performance grant, through a special organizational unit responsible for performance; 2.2. Drafting, development and implementation of policies for the measurement of municipal performance; 2.3. Drafting and updating of the main MPMS document and accompanying professional tools in consultation with
---	--	--

2.4. Funksionimin e SMPK-së duke përfshirë procedurën e mbledhjes, përpunimit, verifikimit dhe raportimit të të dhënave, periudhën e raportimit dhe linjat e llogaridhënies gjatë procesit të raportimit dhe sigurimit të cilësisë së të dhënave; 2.5. Lehtësimin e ushtrimit të roleve dhe përgjegjësi të secilit organ përgjegjës për funksionimin e SMPK-së në pajtim me këtë Rregullore 2.6. Definimin e saktë të fushave, rezultateve dhe treguesëve të SMPK-së, duke mundësuar që të jenë të matshëm, relevant, të definuar mirë, të krahasueshëm dhe që masin përpjekjen e vet komunës në ofrimin e shërbimeve për qytetarë; 2.7. Zbatimin e procedurave për ndryshimin e SMPK-së; 2.8. Administrimin e sistemit të performancës komunale dhe sistemit informativ, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për administratë publike dhe në koordinim me Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit; 2.9. Monitorimin dhe përkrahjen e komunave në zbatimin e SMPK-së;	2.4. Funksionisanje SUOU-a, duke përfshirë postupak përmbledhjes, obrade, verifikacije i izveštavanja podataka, učestalost izveštavanja i linije odgovornosti tokom procesa izveštavanja i osiguranja kvaliteta podataka; 2.5. Olakšavanje izvršavanja uloga i odgovornosti svakog organa odgovornog za funkcionisanje SUOU-a u skladu sa ovom Uredbom 2.6. Tačno definisanje oblasti, rezultata i pokazatelja SUOU-a, omogućavajući da budu merljivi, relevantni, dobro definisani, uporedivi i koji mere sopstveni napor opštine u pružanju usluga za građane; 2.7. Sprovođenje postupaka za izmenu SUOU-a; 2.8. Administracija sistema opštinskog učinka i informacionog sistema, u saradnji sa nadležnim ministarstvom za javnu upravu i u koordinaciji sa Agencijom za informaciono društvo; 2.9. Praćenje i podrška opština u sprovođenju SUOU-a;	the municipalities and other stakeholders; 2.4. Functioning of SMPK including data collection, processing, verification and reporting procedure, reporting period and accountability lines during the reporting and data quality assurance process; 2.5. Facilitation of the exercise of roles and responsibilities of each body responsible for the functioning of the MPMS in accordance with this Regulation; 2.6. Accurate definition of the areas, results and indicators of the MPMS, allowing them to be measurable, relevant, well-defined, comparable and that measure the municipality's own effort in providing services to citizens; 2.7. Implementation of procedures for amending the MPMS; 2.8. Administration of the municipal performance system and information system, in cooperation with the ministry responsible for public administration and in coordination with the Agency of Information Society;
---	---	--

2.10. Përpunimin e të dhënave dhe informatave për performancën e komunave dhe publikimin e raportit të performancës; 2.11. Sigurimin e zbatimit të rregullave të grantit për performancë komunale dhe ridefinimin e politikave të grantit në konsultim me komunitet dhe kontributdhënësit, në pajtim me këtë rregullore; 2.12. Pranimin dhe shqyrtimin e ankesave dhe interpretimin e çështjeve të tjera lidhur me SMPK-në dhe menaxhimin e grantit për performancë komunale; 2.13. Koordinimin dhe bashkëpunimin me komuna dhe partnerë të tjerë të interesuar për funksionimin e SMPK-së dhe kontributdhënësit në grantin e performancës komunale.	2.10. Obradu podataka i informacija o učinku opština i objavljivanje izveštaja o učinku; 2.11. Osiguranje sprovođenja pravila granta o opštinskom učinku i redefinisane politike granta u konsultaciji sa opštinama i doprinosiocima sklada sa ovom uredbom; 2.12. Prijem i razmatranje žalbi i tumačenje drugih pitanja koja se odnose na SUOU i upravljanje grantom za opštinski učinak; 2.13. Koordinacija i saradnja sa opštinama i drugim partnerima zainteresovanim za funkcionisanje SUOU-a i doprinosioca u grantu opštinskog učinka.	2.9. Monitoring and support to municipalities in the implementation of the MPMS; 2.10. Processing of data and information on municipal performance and publication the performance report; 2.11. Ensuring implementation of the grant performance rules and redefinition of the grant policies in consultation with municipalities and contributors, in accordance with this Regulation; 2.12. Receipt and revision of complaints and interpretation of other issues related to the MPMS and municipal performance grant management; 2.13. Coordination and cooperation with municipalities and other partners interested in the functioning of the MPMS and contributors to the municipal performance grant.
Neni 7 Detyrat dhe përgjegjësitë e komunës	Član 7. Zadaci i odgovornosti opštine	Article 7 Duties and responsibilities of the municipality
1. Komuna është përgjegjëse për krijimin e kushteve për funksionimin efikas të SMPK-së.	1. Opština je odgovorna za stvaranje uslova za efikasno funkcionisanje SUOU-a.	1. The municipality shall be responsible for creating conditions for the effective functioning of the MPMS.

2. Me qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, komuna siguron: 2.1. Bashkëpunim me ministrinë për qëllim të ndërtimit, zhvillimit dhe zbatimit të SMPK-së; 2.2. Mbledhjen e të dhënave për performancën e komunës për treguesit sipas fushave të përcaktuara në dokumentin kryesor të SMPK-së; 2.3. Verifikimin dhe miratimin e të dhënave për performancën e komunës; 2.4. Raportimin e të dhënave të miratuara në ministri sipas afateve me këtë rregullore; 2.5. Publikimin e raportit të performancës në faqen zyrtare të komunës; 2.6. Prezantimin e raportit vjetor të performancës dhe diskutimin e rekomandimeve në kuvendin e komunës; 2.7. Adresimin e rekomandimeve të raportit të performancës për përmirësimin e shërbimeve përkatëse për qytetarët dhe sigurimin e qeverisjes së mirë;	2. U cilju sprovođenja ove uredbe, opština osigurava: 2.1. Saradnju sa ministarstvom u cilju izgradnje, razvoja i sprovođenja SUOU-a; 2.2. Prikupljanje podataka za učinak opštine o pokazateljima prema oblastima utvrđenim u glavnom dokumentu SUOU-a; 2.3. Verifikaciju i odobrenje podataka o učinku opštine; 2.4. Izveštavanje podataka odobrenih u ministarstvu u skladu sa rokovima ove uredbe; 2.5. Objavljivanje izveštaja učinka na zvaničnoj veb stranici opštine; 2.6. Predstavljanje godišnjeg izveštaja učinka i raspravljanje o preporukama u skupštini opštine; 2.7. Sprovođenje preporuka izveštaja o učinku za poboljšanje relevantnih usluga za građane i obezbeđivanje dobrog upravljanja;	2. In order to implement this Regulation, the municipality shall ensure: 2.1. Cooperation with the Ministry in order to build, develop and implement MPMS; 2.2. Collection of data on municipal performance for indicators according to the areas identified in the main document of the MPMS; 2.3. Verification and approval of municipal performance data; 2.4. Reporting of approved data in the Ministry in accordance with the deadlines of this Regulation; 2.5. Publication of the performance report on the official website of the Municipality; 2.6. Presentation of the Annual Performance Report and discussion of recommendations in the municipal assembly; 2.7. Addressing of Performance Report recommendations to improve the relevant services for citizens and to ensure good governance;
---	--	--

3. Kryetari i komunës është instanca më e lartë vendimmarrëse për SMPK në nivel lokal, përgjegjës për: 3.1. Caktimin e koordinatorit komunal për performancë; 3.2. Në bashkëpunim me udhëheqësit e njëjësive koordinon caktimin e zyrtarëve komunal për raportim të performancës; 3.3. Miratimin e tërësisë së të dhënave për performancën komunale, para raportimit në ministri. 4. Caktimi i koordinatorit komunal për performancë dhe zyrtarëve përgjegjës për raportim bëhet me vendim të kryetarit të komunës dhe dërgohet në ministri.	3. Gradonačelnik je najviša instanca za donošenje odluka za SUOU na lokalnom nivou, i odgovoran je za: 3.1. Imenovanje opštinskog koordinatora za učinak; 3.2. U saradnji sa rukovodiocima jedinica koordiniše imenovanje opštinskih službenika za izveštavanje o učinku; 3.3. Odobrenje svih podataka za opštinski učinak, pre izveštavanja u ministarstvu. 4. Imenovanje opštinskog koordinatora za učinak i službenika odgovornih za izveštavanje vrši se odlukom gradonačelnika i šalje se u ministarstvu.	3. The Mayor is the highest decision-making authority on MPMS at the local level, and is responsible for: 3.1. Appointment of a Municipal Performance Coordinator; 3.2. Coordination of appointment of municipal officials for performance reporting, in cooperation with the heads of the units; 3.3. Approval of all municipal performance data, before reporting to the Ministry. 4. The appointment of a municipal performance coordinator and reporting officers shall be made by a decision of the Mayor and is sent to the Ministry.
Neni 8 Kriteret për caktimin e koordinatorit komunal për performancë 1. Kryetari i komunës duhet të marr për bazë përgjegjësinë, kompleksitetin, shkathhtësitë, kualifikimet dhe përvojën profesionale me rastin e caktimit të koordinatorit për performancë.	Član 8 Kriterijumi za imenovanje opštinskog koordinatora za učinak 1. Gradonačelnik treba da uzme u obzir odgovornost, složenost, veštine, kvalifikacije i profesionalno iskustvo prilikom imenovanja koordinatora za učinak	Article 8 Criteria for the appointment of the Municipal Performance Coordinator 1. The Mayor shall take into account the responsibility, complexity, skills, qualifications and professional experience when appointing a performance coordinator.

2. Koordinator duhet të jetë person me integritet të lartë dhe me kompetencë profesionale në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi për koordinimin e procesit të matjes së performancës në komunë. 3. Mandati i koordinorit caktohet në vendim të kryetarit të komunës.	2. Koordinator treba da bude lice sa visokim integritetom i profesionalnim kompetencijama u vršenju dužnosti i odgovornosti za koordinaciju procesa merenja učinka u opštini. 3. Mandat koordinatora utvrđuje se odlukom gradonačelnika.	2. The Coordinator shall be a person with high integrity and professional competence in the exercise of duties and responsibilities for the coordination of municipality performance measurement process. 3. The mandate of the coordinator shall be set by a decision of the Mayor.
KAPITULLI IV MATJA E PERFORMANCËS KOMUNALE	POGLAVLJE IV MERENJE OPŠTINSKOG UČINKA	CHAPTER IV MUNICIPAL PERFORMANCE MEASUREMENT
Neni 9 Procesi i matjes së performancës	Član 9 Proces merenja učinka	Article 9 Performance measurement process
1. Matja e performancës organizohet në baza të rregullta vjetore nga ministria. 2. Ministria dhe komuna sigurojnë resurset e nevojshme për zbatimin e procesit të matjes së performancës, përmes strukturave përgjegjëse për performancë komunale.	1. Merenje učinka se organizuje na redovnim godišnjim osnovama od strane ministarstva. 2. Ministarstvo i opština obezbeđuju neophodne resurse za sprovođenje procesa merenja učinka, kroz strukture odgovorne za opštinski učinak.	1. Performance measurement is organized on a regular annual basis by the Ministry. 2. The Ministry and the municipality provide the necessary funds for the implementation of the performance measurement process, through the structures responsible for municipal performance.
Neni 10 Fillimi i procesit të matjes së performancës	Član 10 Početak procesa merenja učinka	Article 10 Initiation of the performance measurement process
1. Procesi i matjes së performancës fillon me dërgimin e kërkesës për raportim në komunë nga ministria.	1. Proces merenja učinka počinje podnošenjem zahteva za izveštavanje od strane ministarstva.	1. The performance measurement process begins once the Ministry submits a request to the Municipality for reporting.

2. Kërkesa për raportim nënshkruhet nga sekretari i ministrisë dhe i dërgohet kryetarit të komunës dhe koordinatorit për performancë komunale. 3. Kërkesa për raportim dërgohet në komunë të paktën 7 (shtatë) ditë para rrjedhjes së afatit për raportim. 4. Njësia përgjegjëse në ministri koordinon procesin e matjes së performancës, përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për raportim, njoftimin paraprak të komunave, ofrimin e këshillave dhe udhëzimeve të tjera administrative, teknike dhe profesionale.	2. Zahtev za izveštavanje potpisuje se od strane sekretara ministarstva i dostavlja se gradonačelniku opštine i koordinatoru opštinskog učinka. 3. Zahtev za izveštavanje dostavlja se u opštini najmanje 7 (sedam) dana pre roka za izveštavanje. 4. Nadležna jedinica u ministarstvu koordinira proces merenja učinka, pripremu potrebne dokumentacije za izveštavanje, preliminarno obaveštavanje opština, pružanje saveta i drugih administrativnih, tehničkih i profesionalnih uputstava.	2. The request for reporting shall be signed by the Secretary of the Ministry and is submitted to the Mayor and the Municipal Performance Coordinator. 3. The request for reporting shall be submitted to the Municipality at least 7 (seven) days before the reporting deadline. 4. The responsible unit within the Ministry coordinates the process of performance measurement, preparation of the necessary documentation for reporting, preliminary notification of municipalities, provision of advice and other administrative, technical and professional instructions.
Neni 11 Menaxhimi i procesit të matjes së performancës në komunë	Član 11 Upravljanje procesom merenja učinka u opštini	Article 11 Management of the Municipal performance measurement process
